



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 587/ Prot.

Tiranë, më 19.04.2021

VENDIM

Nr. 52, datë 19.04.2021

PËR  
MIRATIMIN E PAKETËS RREGULLATIVE  
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN  
E KOMISONIT PËR KURRIKULAT SI DHE NJËSISË SË KURRIKULAVE NË UST

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të UST, si dhe gjithë kuadrit ligjor në fuqi për mbarëvajtjen dhe procesin mësimor në UST, Senati Akademik i UST-së, në mbledhjen e tij të datës 19.4.2021

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Komisionit për Kurrikulat në UST (rregullorja bashkëngjitur).
2. Të miratojë Rregulloren për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në UST (rregullorja bashkëngjitur).
3. Ky vendim Hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë së Komisionit për Kurrikulat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

**RREGULLORE E ORGANIZIMIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT PËR  
KURRIKULAT**

**Neni 1**

**Komisioni për Kurrikulat**

1. Komisioni për Kurrikulat është organ kolegjal vendimarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e studimeve sipas Statutit të UST-së.
2. Komisioni për Kurrikulat ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të vetë kandidimit të Personelit Akademik. Anëtari i pestë është student, dhe zgjidhet nga Këshilli Studentor. Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
3. Komisioni kontrollon veprimtarinë e Njesisë së Kurrikulave, mbi bazën e një raportimi periodik 6 mujor nga kjo e fundit.

**Neni 2**

**Zgjedhja e kryetarit**

Komisioni për Kurrikulat në mbledhjen e tij të parë zgjedh kryetarin, nga anëtarët e stafit akademik, i cili do të jetë edhe drejtuesi i tij për periudhën e mandatit të këtij Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 1.

**Neni 3**

**Vendimarrja në Komision**

Mbledhjet e Komisionit quhen të vlefshme, në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me dy të tretat e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi, vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare.



#### **Neni 4**

##### **Afatet e mbledhjes së Komisionit**

Komisioni mblidhet në mbledhje të zakonshme të paktën një herë në tre muaj. Në raste të nevojshme, kryetari mund të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme. Për çështje të caktuara, ai kërkon që në mbledhjet e Komisionit pa të drejtë vote të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve drejtuese të Institucionit, dhe/ose edhe persona të tjerë nga stafi akademik.

#### **Neni 6**

##### **Fusha e veprimtarisë së Komisionit**

1. Komisioni për Kurrikulat përcakton drejtimet kryesore, në lidhje me fizionominë e Institucionin për natyrën e programeve të studimit që ai duhet të ofrojë.
2. Komisioni për Kurrikulat është përgjegjës për përcaktimin e politikave orientuese në drejtim të hapjes së programeve të reja të studimit, si dhe të përmirësimit të atyre ekzistuese në përputhje me Standartet Shtetërorë të Cilësisë në Arsimin e Lartë, dhe atyre të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL).
3. Komisioni për Kurrikulat , i propozon Senatit akademik, pasi ka marrë edhe mendimin e Njësisë së Kurrikulave, nevojën e ndryshimeve në kurrikula dhe programe studimeve, në përputhje me nevojat e tregut.
4. Komisioni për Kurrikulat , në raste të caktuara kur e shikon të arsyeshme, mund të zhvillojë edhe mbledhje të përbashkëta me Komisione të tjera për nevojat e Institucionit, në drejtim të përcaktimit të politikave orientuese për hapjen e programeve të reja, rifreskimit të atyre ekszituese, si dhe çështje të tjera të natyrës mësimore dhe akademike.

#### **Neni 7**

##### **Hyrja në fuqi e Rregullores**

Kjo Rregullore hyn në fuqi, pasi miratohet nga Senati Akademik.



Rregullore Për Mbarvajtjen e Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në UST



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

**RREGULLORE**  
**“PËR MBARVAJTJEN E KURRIKULAVE DHE PROCESIT MËSIMOR NË UST**  
*(Njësia e Kurrikulave)*

**Neni 1**  
**Qëlimi**

Me këtë Rregullore rregullohen të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të kurrikulave, si dhe të procesit mësimor në UST.

**Neni 2**  
**Baza ligjore**

1. UST, krijon kushte të përshtatshme për ofrimin në formë dhe përmbajtje të kurrikulave bashkëkohore, në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë së Arsimit të Lartë, si dhe ato të Hapërsirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL).
2. UST, në hartimin e kurrikulave dhe realizimin e procesit mësimor vepron në përputhje me kuadrin ligjor për Arsimin e Lartë - Ligjin Nr. 80/2015, Statutin e UST-së dhe Rregulloret e tij.

**Neni 3**  
**Sruktura për mbarvajtjen e kurrikulave dhe mësimin në UST**

Pranë UST-së, ngrihet dhe vepron në funksion të Zhvillimit të Kurrikulave dhe procesit mësimor:

1. Komisioni për kurrikulat;
2. Njësia e Kurrikulave.



#### **Neni 4**

##### **Komisioni për Kurrikulat**

1. Komisioni për Kurrikulat është organ kolegjal vendimarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e studimeve, sipas Statutit të UST-së.
2. Komisioni për Kurrikulat ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të vetë kandidimit. Anëtari i pestë është student, dhe zgjidhet nga Këshilli Studentor. Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
3. Komisioni për Kurrikulat përcakton drejtimet kryesore, në lidhje me fizionominë e Institucionin për natyrën e programeve të studimit që ai duhet të ofrojë.
4. Komisioni për Kurrikulat është përgjegjës për përcaktimin e politikave orientuese në drejtim të hapjes së programeve të reja të studimit, si dhe të përmirësimit të atyre ekzistuese në përputhje me Standartet Shtetërore të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
5. Komisioni kontrollon veprimtarinë e Njesisë së Kurrikulave, mbi bazën e një raportimi periodik 6 mujor nga kjo e fundit.

#### **Neni 5**

##### **Zv/rektori përgjegjës**

1. Njësia e Kurrikulave funksionon pranë Rektoratit të UST-së **sipas përcaktimeve të strukturës organike dhe Statutit**. Ajo mbikqyr, promovon dhe orienton përmirësimin dhe ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulës.
2. Zv/Rektori për procesin mësimor është përgjegjës për mbarvajtjen e Njesisë së Kurrikulave, dhe mbikqyr veprimtarinë e saj.

#### **Neni 6**

##### **Funksionet kryesore të Zyrës së Kurrikulave**

1. Njësia e Kurrikulave në lidhje të ngushtë me të gjitha njësitë përbërëse të UST-së, punon për hartimin e programeve të reja të studimit, të ndryshimit të atyre ekzistuese, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës deri në zbatimin e tyre.



Rregullore Për Mbarvajtjen e Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në UST

2. Njësia e Kurrikulave ndjek veprimtarinë operative (mësimore) që lidhet me të gjitha ciklet e studimit, në sistemin me kohë të plotë.
3. Njësia e Kurrikulave merr pjesë në hartimin e projekt-dokumentacionit për emërtimet e diplomave për të gjitha ciklet e studimit.
4. Njësia e Kurrikulës ka detyrimin të japë në çdo rast mendime dhe rekomandime me shkrim gjatë mbledhjeve të Senatit Akademik kur merren në shqyrtim çështje të kurrikulave.
5. Kjo njësi bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me njësitë bazë të universitetit si dhe me NJSBC-të. Ajo kryen në vijimësi studime të thelluara mbi modelet dhe praktikatat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare mbi kurrikulat.
6. Njësia e Kurrikulave kontrollon dhe është përgjegjëse për koordinimin dhe vlerësimin semestral të programeve mësimore, jep mendime me shkrim për aplikimin e programeve të reja studimore ose ndryshimin e tyre, si dhe ndihmon procesin e rekrutimit të punësit të stafit akademik, duke dhënë rekomandime përkatëse për kriteret specifike të kërkuara për kandidatet sipas lëndëve/moduleve që ata do të mbulojnë.
7. Njësia e Kurrikulave është përgjegjëse dhe kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për hartimin, organizimin dhe zbatimin e programeve të reja të studimit dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e detyrave të lëna nga ASCAL dhe strukturat e tjera vendimmarrëse universitare lidhur me përputhshmërinë dhe rregullsinë e kurrikulave.

## **Neni 7**

### **Detyra të tjera të Njesise se Kurrikulave**

1. Njësia e Kurrikulave mbështet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në rastet e përgatitjes së raporteve për vlerësime të programeve të studimit, si për qëllim akreditimi, ashtu edhe për rastet e hapjes së programeve të reja, gjithmonë brenda kompetencës së saj, për çështje të kurrikulave dhe ato mësimore-kërkimore.
2. Njësia e Kurrikulave mund të kërkojë edhe angazhimin e ekspertëve të jashtëm, sipas fushës dhe problematikës, në përgatitjen e vlerësimit të programeve mësimore.
3. Njësia e Kurrikulave përgatit dokumentacionin e nevojshëm për mbledhjet e Senatit Akademik që lidhen me programet e studimit si dhe jep në çdo rast mendime dhe rekomandime me shkrim për çështje të kurrikulave.
4. Harton Analizën Vjetore mësimore të programeve të studimit bazuar në analizat e njësive kryesore të UST-se duke e përgatitur atë për mbledhjen e Senatit Akademik.
5. Me porosi të Rektorit, jep konsulencë për problematikatat që lidhen me natyrën e veprimtarisë së kësaj Njësie.



### **Neni 8**

#### **Roli i Njësisë në vlerësimin e programeve të studimit**

Roli i Njësisë në vlerësimin e programeve të studimit, përfshin:

1. Marrjen në konsideratë të propozimi në nivel departamenti për hapjen e programeve të reja të studimit apo ndryshimin e atyre ekzistuese;
2. Bashkëpunimin me pedagogët e departamentit, me studentët, apo marrjen në konsideratë të nevojave të tregut të punës;
3. Bashkëpunim me grupin e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, i cili shqyrton dhe punon për hartimin apo ndryshimin e programit të studimit;
4. Shqyrtimin dhe vlerësimin nga ana teknike e propozimeve të departamentit, të cilat më pas i dërgon për informacion NjBSC, e cila e paraqet pranë Senatit Akademik për miratim.

### **Neni 9**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi, pas miratimit nga Senati Akademik.

